

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

## FAKULTETI I EDUKIMIT - QENDRA NË PRISHTINË

<b>Titulli i kursit:</b>	Gjuhë shqipe, I
<b>Niveli dhe lloji i kursit:</b>	Bachelor - obligativ
<b>Programi:</b>	Fillor
<b>Viti dhe semestri:</b>	Viti I – semestri I
<b>Numri i orëve në javë:</b>	5 orë në javë (3 + 2)
<b>Kodi – shifra e lëndës:</b>	Edu 101 D
<b>Vlera në kredi ECTS:</b>	7
<b>Koha – lokacioni:</b>	Salla nr. 26, e hënë 9-11,20 , E shtunë, 13-15,20
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof.asc.Begzad Baliu
<b>Telefoni:</b>	Mob. 044 173-596;
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:bbaliu@hotmail.com">bbaliu@hotmail.com</a>
<b>Asistenti:</b>	Mr. Shpetim Elezi
<b>Konsultime:</b>	Kabineti nr. 2
<b>Orari i konsultimeve:</b>	E marte: 11:00-13:00

### 1. Qëllimet e kursit (modulit):

- Meqë gjuha amtare është një lëndë me rëndësi të veçantë, e cila ka funksion të trefishtë: si mjet komunikimi, gjuhë mësimore dhe lëndë mësimi, nënkupton edhe nevojën që studentët:
- Përmes kursit të gjuhës amtare (shqipe) I, në saje edhe të përgatitjeve paraprake, t'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e gjuhësisë në përgjithësi e të fonetikës – fonologjisë në veçanti;
  - Që të njihen teorikisht dhe praktikisht me elementet themelore të sistemit fonetike-fonologjik dhe të normës gjuhësore: drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore (të dallojnë tingujt nga morfemat; klasifikimin dhe nyjëtimin e tyre; veçoritë e theksit; intonacionin, dukuritë fonetike etj);
  - Të fitojnë aftësi për të dalluar trajtat dhe format normative nga ato që nuk janë normative në ligjërimin e folur dhe të shkruar, në mënyrë që t'i zbatojnë këto aftësi në të ardhmen te fëmijët e ciklit të ulët të shkollës fillore.

### 2. Rezultatet e pritura nga kursi

- Studentët do të pajisen me njohuri përkatëse nga fusha e kursit të gjuhës amtare (2-3 njësi të përgjithshme dhe fonetika e fonologjia). Kështu që ata do të aftësohen:
- të fitojnë njohuri bazë për fonologjinë standarde të gjuhës shqipe;
- të dinë t'i dallojnë njësitë fonetike-fonologjike në tekst;
- t'i njohin karakteristikat nyjëtimore dhe kundërvëniet fonologjike të fonemave dhe të alafoneve;
- t'i dinë mjetet prozodike dhe funksionin e tyre (të mësojnë për përndarjen e fonemave);
- të dinë drejtshkrimin për të shkruar sipas rregullave të gjuhës shqipe standarde;

- të jenë në gjendje t'i identifikojnë shkallët e zhvillimit të drejtshqiptimit të nxënësit të shkollës fillore;
- me rastin e punës në grupe, përmes dialogut të hapur demokratik e konstruktiv, lirshëm të shprehin mendimet dhe vlerësimet e tyre, duke plotësuar njohuritë e njëri tjetrit etj.

### 3. Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

1. Nga njohuritë e fituara, të kenë shkathtësi profesionale (teorike-praktike) dhe ato t'i sendërtojnë me sukses të plotë në jetën e tyre gjatë studimeve dhe në punën e tyre të ardhshme me nxënësit filloristë.
2. Të mburren me potencialin dituror të fituar në këtë fushë të gjuhësisë dhe, jo vetëm përmes teorisë, por edhe përmes ushtrimeve të ndryshme që do të organizohen, do ta materializojnë atë që duhet nxënë në këtë kurs të gjuhës. Ata do të nxiten të jenë në gjendje që edhe vetë t'i zgjedhin metodat dhe strategjitë më bashkëkohore dhe t'i vlerësojnë ato metoda e strategji të cilat edhe do t'i përdorin.
3. Të ndërtojnë një qëndrim të ri dhe të drejtë për rëndësinë e gjuhës, si një proces jo i përfunduar, si ergon, por si energieja, si strukturë e hapur në kuptimin modern të konceptit të Humboldt, duke pasur parasysh funksionin e saj në shoqëri, evolucionin dhe rolin e saj në formimin e personalitetit të njeriut në përgjithësi e të nxënësve të shkollës fillore në veçanti.
4. Me sukseset e arritura në këtë kurs, studentët të fitojnë kurajo e vetëbesimin e tyre për arritjen e sukseseve edhe më të mira në kurset vijuese të gjuhës amtare në të ardhmen dhe në procesin edukativo-arsimor me nxënësit e tyre.

### 4. Metodologjia e mësimdhënies:

I tërë realizimi i kursit do të bëhet duke pasur në epiqendër të vëmendjes e të angazhimit studentin me vlerësimet dhe gjykimet e tij dhe punën (e pavarur) të tij. Si forma mësimi do të jenë ligjëratat, seminarët, diskutimet, puna në grupe etj., duke aplikuar me këtë rast strategjitë dhe teknikat e reja mësimore, si: *insertin*; *parashikimin me terma paraprakë*; *pesëvargëshin*; *kubimin*; *kllasterin*, si dhe teknika e modele të tjera mësimi, për një mësim shumë më të avancuar e efektiv të gjuhës dhe të standardit të saj.

### 5. Literatura themelore:

1. Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, *Gjuhë amtare* (Njohuri për gjuhën – fonetikë – morfologji - sintaksë) për studentët e Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2010.
2. Bahri Beci, *Fonetika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
3. Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997.

### 2. Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java I: Gjuha dhe gjuhësia; Familja gjuhësore indoevropiane dhe gjuha shqipe; Prejardhja e gjuhës shqipe;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, *Gjuhë amtare* për studentët e Fakultetit të Edukimit, UP, Prishtinë, 2010, f. 5-11.

Java II: Dokumentimi i shqipes së shkruar; Dialektet dhe gjuha standarde (letrare) shqipe;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.14-22.  
Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaç, Dialektologjia, Tiranë, 1997.

Java III: Gjuha e shkruar dhe drejtshkrimi i gjuhës shqipe;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.27-30  
Drejtshqiptimi dhe stilet e shqiptimit;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.33-35

Java IV: Njohuri për fonetikën; Objekti i fonetikës dhe rëndësia e studimit të fonetikës;  
Fonema dhe veçoritë e tingujve të folurit;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.39-44  
Bahri Beci, Fonetika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004, 10

Java V: Klasifikimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.45-47  
Bahri Beci, vepra e cituar, f. 22

Java VI: Ndërrimet e fonemave: a) ndërrimet opozicionale dhe b) ndërrimet kombinatorë: përngjashmimi (asimilimi); shpërngjashmimi (disimilimi); vendkëmbimi (metateza); fjalë me shtesa tingujsh; fjalë me rënie tingujsh;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.53-56  
Bahri Beci, vepra e cituar, f. 106-109

Java VII: Ndërrimet historike të fonemave: metafonia, Qiellzorëzimi (palatalizimi), rotacizmi;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f. 57-59  
Bahri Beci, vepra e cituar, f. 109-111.

### **Vlerësimi i parë intermediar**

Java VIII: Njësitë fonetike dhe theksat në gjuhën shqipe: ndarja fonetike e të folurit; tingulli; rrokja; ndarja e fjalëve në rrokje; rregullat drejtshkrimore të ndarjes së fjalës në fund të rreshtit;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.62-64

Java IX: Fjala fonetike; sintagma; fraza; theksi i fjalëve dhe veçoritë e tij në gjuhën shqipe;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f. 65-68  
Bahri Beci, vepra e cituar, f. 113.

Java X: Lidhjet kuptimore të fjalëve në gjuhën shqipe: sinonimet, antonimet, homonimet;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.82-86

Java XI: Frazologjia e gjuhës shqipe

Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f. 99-104  
Java XII: Stilet funksionale në gjuhën shqipe: kuptimet për stilin; mjetet me vlerë stilistike dhe norma stilistike; veçoritë e stileve funksionale të gjuhës shqipe;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar,f. 111-115

### **Vlerësimi i dytë intermediar**

**Vërejtje:** *Studentët tri javë janë në mësim praktik*

### **Provimi përfundimtar**

#### **7. Plani për vlerësim:**

Studentët do të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke përcjellë aktivitetin e tyre në mësim dhe përmes ushtrimeve gjatë tërë semestrit.  
Nota përfundimtare do të bazohet në:

- Vlerësimin e parë: 30%;
- Vlerësimin e dytë: 25%;
- Detyrat e shtëpisë ose angazhime të tjera: 10%
- Vijimin e rregullt: 5%
- Provimin final: 30%
- **Gjithsej 100%**

#### **8. Nota përfundimtare**

10	90% ...+
9	80 - 89%
8	71 - 79%
7	62 - 70%
6	51 - 61%
5	0 – 50%

#### **9. Literatura plotësuese:**

1. Prof.dr.Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Prishtinë, 2001.
2. Prof.dr.Fadil Raka, Histori e gjuhës shqipe, Tetovë, 1997.
3. Grup autorësh, Tekst ushtrimesh të gjuhës shqipe I (Për studentët e Fakultetit të Mësuesisë dhe të Degës së Gjuhëve të Huaja), Tiranë, 1998
4. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1974.
5. Ali Jashari@Bahtijar Kryeziu, Gjuhë amtare, I,II, II, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Prishtinë, 2010
6. Gjovalin Shkurtaç, Shqipja e sotme, UFO, Tiranë, 2010

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

## FAKULTETI I EDUKIMIT - QENDRA NË PRISHTINË

<b>Titulli i kursit:</b>	Gjuhë shqipe, II
<b>Niveli dhe lloji i kursit:</b>	Bachelor - obligativ
<b>Programi:</b>	Fillor
<b>Viti dhe semestri:</b>	Viti I – semestri II
<b>Numri i orëve në javë:</b>	5 orë në javë (3 + 2)
<b>Kodi – shifra e lëndës:</b>	Edu 109 D
<b>Vlera në kredi ECTS:</b>	7
<b>Koha – lokacioni:</b>	E hënë – e martë
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof.dr.Begzad Baliu
<b>Telefoni:</b>	Mob. 044 173-596
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:bbaliu@hotmail.com">bbaliu@hotmail.com</a> ;
<b>Asistenti:</b>	Mr. Shpëtim elezi
<b>Konsultime:</b>	Kabineti i fakultetit, nr. 2.
<b>Orari i konsultimeve:</b>	E hënë – e enjte 11- 13

### 1. Qëllimet e kursit (modulit)

Meqë gjuha amtare është një lëndë me rëndësi të veçantë, e cila ka funksion të trefishtë: si mjet komunikimi, gjuhë mësimore dhe lëndë mësimi, nënkupton edhe nevojën që studentët:

- Përmes kursit të gjuhës amtare (shqipe) II, në saje edhe të përgatitjeve që kanë arritur (nga shkollimi paraprak dhe nga kursi I i gjuhës i mbajtur në semestrin paraprak), t'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e gjuhësisë në përgjithësi e të morfologjisë në veçanti;
- Të njihen teorikisht dhe praktikisht me strukturën morfologjike të fjalës, elementet e fjalëformimit, pjesët e ligjëratës dhe normën gjuhësore: drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore (të dallojnë morfemat fjalëformuese dhe trajtëformuese; pjesët e ndryshueshme të ligjëratës: emrin, (nyjat), mbiemrin, numërorin, përemrin, foljen; pjesët e pandryshueshme: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, pasthirrmat etj);
- Të fitojnë aftësi për të dalluar trajtat dhe format normative nga ato që nuk janë normative në ligjërimin e folur dhe në atë të shkruar, në mënyrë që t'i zbatojnë këto aftësi në të ardhmen të nxënësit e ciklit të ulët të shkollës fillor.

### 2. Rezultatet e pritura nga kursi

- Studentët do të pajisen me njohuri përkatëse nga fusha e kursit të gjuhës amtare (morfologjinë, objektin e studimit të saj, strukturën morfologjike të fjalës dhe pjesët e ndryshueshme e të pandryshueshme të ligjëratës). Kështu që ata do të aftësohen:
- të fitojnë njohuri bazë për morfologjinë si disiplinë shumë e rëndësishme për mësimin e gjuhës shqipe standarde;
- të njihen me strukturën e fjalës dhe mënyrat e fjalëformimit me

- qëllim të formimit të fjalëve të reja si formë e mirë për të pasuruar fjalorin e tyre;
- të dinë t'i dallojnë pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës;
  - të njihen me rregullat e ndryshme të pjesëve të ligjëratës për mësimin e gjuhës standarde shqipe;
  - të mësojnë drejtshkrimin për të shkruar sipas rregullave të gjuhës shqipe standarde;
  - të jenë në gjendje t'i identifikojnë shkallët e zhvillimit të drejtshqiptimit të nxënësit e shkollës fillore;
  - me rastin e punës në grupe, përmes dialogut të hapur demokratik e konstruktiv, lirshëm të shprehin mendimet dhe vlerësimet e tyre, duke plotësuar njohuritë e njëri tjetrit etj.

### **3. Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:**

1. Nga njohuritë e fituara, të kenë shkathtësi profesionale (teorike-praktike) dhe ato t'i sendërtojnë me sukses të plotë në jetën e tyre gjatë studimeve dhe në punën e tyre të ardhshme me nxënësit filloristë.
2. Të mburren me potencialin dituror të fituar në këtë fushë të gjuhësisë dhe, jo vetëm përmes teorisë, por edhe përmes ushtrimeve të ndryshme që do të organizohen; ta materializojnë atë që duhet nxënë në këtë kurs të gjuhës etj. Ata do të nxiten të jenë në gjendje që edhe vetë t'i zgjedhin metodat dhe strategjitë më bashkëkohore dhe t'i vlerësojnë ato metoda e strategji të cilat edhe do t'i përdorin.
3. Të ndërtojnë një qëndrim të ri dhe të drejtë për rëndësinë e gjuhës, si një proces jo i përfunduar, si ergon, por si energieja, si strukturë e hapur në kuptimin modern të konceptit të Humboldt, duke pasur parasysh funksionin e saj në shoqëri, evolucionin dhe rolin e saj në formimin e personalitetit të njeriut në përgjithësi e të nxënësve të shkollës fillore në veçanti.
4. Me sukseset e arritura në këtë kurs, studentët të fitojnë kurajo e vetëbesimin e tyre për arritjen e sukseseve edhe më të mira në kurset vijuese të gjuhës amtare në të ardhmen dhe në procesin edukativo-arsimor me nxënësit e tyre.

### **4. Metodologjia e mësimdhënies:**

I tërë realizimi i kursit do të bëhet duke pasur në epiqendër të vëmendjes e të angazhimit studentin me vlerësimet dhe gjykimet e tij dhe punën (e pavarur) të tij. Si forma mësimi do të jenë ligjëratat, seminarët, diskutimet, puna në grupe etj., duke aplikuar me këtë rast strategjitë dhe teknikat e reja mësimore, si: *insertin; parashikimin me terma paraprakë; pesëvargëshin; kubimin; kllasterin*, si dhe teknika e modele të tjera mësimi, për një mësim shumë më të avancuar e efektiv të gjuhës dhe të standardit të saj.

### **5. Literatura themelore:**

1. Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, *Gjuhë amtare* (Njohuri për gjuhën – fonetikë – morfologji - sintaksë) për studentët e Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2010.

## **6. Plani i detajzuar i mësimit për një semestër:**

- Java I: Morfologjia (njohuri të përgjithshme);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.129?-133  
Struktura morfologjike e fjalës dhe tipat e fjalëformimit;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.137-143
- Java II: Pjesët e ligjëratës – emri (përkufizimi dhe veçoritë kryesore);  
Kategoria gramatikore e gjinisë; kategoria gramatikore e numrit;  
kategoria gramatikore e rasës;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.157-165  
Tipat e lakimit; kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë; Nyjat në  
gjuhën shqipe  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.167-171
- Java III: Mbiemri (përkufizimi dhe veçoritë kryesore);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.180-191  
Numërori (përkufizimi dhe veçoritë kryesore);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.197-201
- Java IV: Përemri (përkufizimi dhe veçoritë kryesore – llojet: përemri vetor,  
vetëvetor, dëftor);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.204-210
- Java V: Përemri (përemri pronor, lidhor, pyetës, i pacaktuar);  
drejtpërdorimi i përemrave në ligjërim;  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.211-220
- Vlerësimi i parë intermediar**
- Java VI: Java I: Folja (Folja dhe grupet leksiko-gramatikore të saj; Foljet  
Kalimtare dhe jo kalimtare; Kategoritë gramatikore (veta, numri,  
diateza, mënyra, koha); zgjedhimi i foljeve (ndarja në zgjedhime);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.232-243
- Java VII: Format e shtjelluara (zgjedhimi vepror - zgjedhimi jovepror),  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.244-248
- Java VIII: Format e pashtjelluara të foljes; Formimi i foljeve  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f. 249-251
- Java IX: Ndajfolja (përkufizimi dhe veçoritë kryesore);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.260-264  
Parafjala (përkufizimi dhe veçoritë kryesore: Klasifikimi i parafjalëve  
sipas prejardhjes dhe strukturës morfologjike; Klasifikimi i tyre sipas  
kriterit sintaksor; Përdorimi i parafjalëve në ligjërim);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.269-275
- Java X: Lidhëza (përkufizimi dhe veçoritë kryesore);  
Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, vepra e cituar, f.278-279
- Java XI: Pjesëza - pasthirrmat (përkufizimi dhe veçoritë kryesore të tyre);

## Vlerësimi i dytë intermediar

Vërejtje: *Studentët katër javë janë në mësim praktik.*

### Provimi përfundimtar

#### 7. Plani për vlerësim:

Studentët do të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke përcjellë aktivitetin e tyre në mësim dhe përmes ushtrimeve gjatë tërë semestrit.

Nota përfundimtare do të bazohet në:

- Vlerësimin e parë: 30%;
- Vlerësimin e dytë: 25%;
- Detyrat e shtëpisë ose angazhime të tjera: 10%
- Vijimin e rregullt: 5%
- Provimin final: 30%
- **Gjithsej 100%**

#### 8. Nota përfundimtare:

<i>PRISHTINË PRISHTINË PRISHTINË</i>	9	81 - 89%
8	71 - 80%	
7	61 - 70%	
6	51 - 60%	
5	0 – 50%	

#### 9. Literatura plotësuese:

1. Prof.dr.Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për mësimdhënësit e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1998.
2. Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe I, ASHSH, Tiranë, 2002.
3. Grup autorësh, Tekst ushtrimesh të gjuhës shqipe I (Për studentët e Fakultetit të Mësuesisë dhe të Degës së Gjuhëve të Huaja), Tiranë, 1998.
4. Ali Jashari@Bahtijar Kryeziu, Gjuhë amtare, I,II, II, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Prishtinë, 2010
5. Gjovalin Shkurtaç, Shqipja e sotme, UFO, Tiranë, 2010
6. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1974.